

MNN Qendrore

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

17 Shtator 2025

**Rajonet: Afrika, Azi-Paqësori, Euroazia,
Mesoamerika, Amerika e Jugut, SHBA-
Kanada**



Festimi i 110-vjetorit të MNN-së

Një Shikim i Shpejtë MNN



Në përgjigje të Porosisë së Madhe të Krishtit, u themeluan organizatat misionare nga grupe dhe denominacione të ndryshme. Misionet Ndërkombëtare Nazaretase (MNN) e gjurmojnë origjinën e tyre fillimisht me Shoqatën e Kishave Pentekostale të Amerikës (APCA), dhe në prill të vitit 1899, u themelua Shoqata e Grave Misionare (ShGM).

Shoqata e Grave Misionare u njoh zyrtarisht si një organizatë ndihmëse e Kishës së Nazaretasit në Asamblenë e Përgjithshme të katërt në vitin 1915. Në këtë asamble u rekomandua që çdo kishë lokale të kishte një organizatë të tillë, për të rritur njohurinë dhe interesin për misionet me anë të lutjes, duke ftuar folës të veçantë, duke mbajtur kontakt me misionarët; si dhe për të bashkëpunuar me Bordin e Kishës (lokale) për rritjen e përqindjeve të tyre (për misionet).

Kuvendi i parë i Përgjithshëm i ShGM-së u mbajt në qershor të vitit 1928; në atë Kuvend, anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm u zgjodhën nga vetë Kuvendi (para kësaj Këshilli zgjidhej nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme).

Emri i shërbesës ka ndryshuar gjatë historisë së saj: 1928—Shoqata Misionare e Grave jashtë Vendit, 1952—Shoqata Misionare e jashtme Nazaretase (duke pasqyruar përfshirjen e burrave, të rinjve dhe fëmijëve në organizatë), 1964—Shoqata Botërore Nazaretase, 1980—Shoqata Botërore e Misioneve Nazaretase (duke pasqyruar aspektin ndërkombëtar të organizatës) dhe 2001—Misionet Ndërkombëtare Nazaretase (MNN).

Sot, Misionet Ndërkombëtare Nazaretase janë aktive në mbi 25,000 kisha lokale në të gjithë globin, me një anëtarësi prej 2,781,500 anëtarë. Si një organizatë vullnetare, MNN-ja është zëri mbështetës i misionit global në çdo kishë lokale, duke ushqyer frymën misionare dhe duke mobilizuar njerëzit në veprim, me ndikim tek njerëzit në të gjithë botën.

110 - Vjetori - Fokus i Vecantë: Kujdesi Shëndetësor për Misionarët

Kur vjen një vit i veçantë i Përvjetorit, MNN-ja mobilizon kishën për të reaguar ndaj një nevojë specifike përmes ofertave dhe projekteve që përqendrohen në atë nevojë.

Fokusi i veçantë i 110-vjetorit është në Kujdesin Shëndetësor për Misionarët. Ne përpiqemi ti nderojmë dhe të kujdesemi për misionarët tanë që nga momenti i dërgimit të tyre në shërbesë deri në daljen në pension, duke i bekuar të rinjtë ndërsa kalojnë kufijtë tokësorë për herë të parë me Lajmin e Mirë të Jezusit, si ata të mbështetur financiarisht ashtu edhe ata në detyra globale dhe duke bekuar ata që kanë dhënë jetën e tyre në misione, të cilët tani janë në pension dhe duke u përballur me sfidat e jetesës me të ardhura fikse në mjedise ekonomike të paqëndrueshme.

A do të na bashkohesh edhe ti në këtë vit shumë të rëndësishëm të Përvjetorit, për të festuar dhe mbështetur misionarët tanë duke ndihmuar në lehtësimin e barrës së shpenzimeve në rritje të kujdesit shëndetësor? (Fondi 215)

Gjeni logot [këtu](#).

Faleminderit!

A mund të shërbeni?

A po ju thërret Zoti që të merrni pjesë në misionin e Tij?
Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT